



Republika Kosova
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.451/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, – panelist individual , duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “ Luan SH.P.K & Engineering Group ” SH.P.K – Fushë Kosovë/Deçan , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për dhënie të kontratës OE “TE ALENI ” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : LOTO 2- Betonimi i Kanalit të Ujitjes Vrellë-Lubizhdë ”- me nr. të prok: 633- 20 -1415- 5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Komuna Istog” (KI) , më datën: 06.08.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “ Luan SH.P.K & Engineering Group ” SH.P.K – Fushë Kosovë/Deçan , kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “ LOTO 2 - Betonimi i Kanalit të Ujitjes Vrellë-Lubizhdë ”- me nr. të prok: 633- 20 -1415- 5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Komuna Istog” (KI) ,

II. ANULOHET, Vendimi i AK –së- Njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “ LOTO 2- Betonimi i Kanalit të Ujitjes Vrellë-Lubizhdë ”- me nr. të prok: 633- 20 -1415- 5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Komuna Istog” (KI) , dhe lënda të kthehet në Rivlerësim vetëm për Lotin që është parashtruar ankesë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “ Luan SH.P.K & Engineering Group ” SH.P.K – Fushë Kosovë/Deçan , aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “ Luan SH.P.K & Engineering Group ” SH.P.K – Fushë Kosovë/Deçan , si palë e pa kënaqur kanë deponuar ankesë në OSHP, me 07.07.2020 me nr. 451/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “LOTO 2 - Betonimi i Kanalit të Ujiqes Vrellë-Lubizhdë ”- me nr. të prok: 633- 20 -1415- 5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Komuna Istog” (KI) , duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7 , 59 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.07.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 24.07.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “ Luan SH.P.K & Engineering Group ”
SH.P.K – Fushë Kosovë/Deçan

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Sa i përket pretendimit të parë ku sipas OE ankues, Autoriteti Kontraktues thotë që grupi i OE ankues ka ofruar kamion me kiper me librezë të skaduar, Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të lëndës dhe dokumenteve të tjera përcjellëse, e gjen pretendimin si të pabazuar. Automjeti me regjistrim 03-703-EF i ofruar edhe në

dokumentacionin e ofertës fillestare nga grupi i OE ankues ka regjistrim deri më 07.04.2021 siç edhe është paraqitur në foto (shih faktin numër 1 tek pjesa e tretë e këtij raporti).

Libreza e Autokorpes me numër regjistrimi 01-669-HL ka afat deri më datë 22.05.2021. Një dokument i tillë ka validitet deri me datën e lartpërmendur, datë kjo e cila mund të shihet edhe në dokumentet e OE ankues në ofertën e dërguar sa i përket këtij aktiviteti të prokurimit (shih faktin nr. 1 tek pjesa e 3-të e këtij raporti).

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si pjesërisht e bazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “LOTO 2 – Betonimi i Kanalit të Ujitjes Vrellë-Lubizhdë” me nr. të prokurimit: 633-20-1415-5-2-1, *aktivitet ky i iniciuar nga AK: KK Istog*, të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim, gjegjësisht LOTET përkatëse.

Mendimi i ekspertëve shqyrtues; Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 24.07.2020 me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik, me datë: 24.07.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 06.08.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Autoriteti Kontraktues pa drejtësisht e ka eliminuar atë me arsyetimin se grupi i OE ankues ka ofruar kamion me kiper me librezë të skaduar. Paneli shqyrtues konform Ekspertit

Shqyrtues pas shqyrtimit të lëndës dhe dokumenteve të tjera përcjellëse, e gjen pretendimin si të pabazuar. Kjo për faktin se Automjeti me regjistrim 03-703-EF i ofruar edhe në dokumentacionin e ofertës fillestare nga grupi i OE ankues ka regjistrim deri më 07.04.2021 siç edhe është paraqitur në foto (shih faktin numër 1 tek pjesa e tretë të raportit të ekspertizës së ekspertit shqyrtues).

Po ashtu libreza e Autokorpes me numër regjistrimi 01-669-HL ka afat deri më datë 22.05.2021. Një dokument i tillë ka validitet deri me datën e lartpërmendur, datë kjo e cila mund të shihet edhe në dokumentet e OE ankues në ofertën e dërguar sa i përket këtij aktiviteti të prokurimit (shih faktin nr. 1 tek pjesa e 3-të të raportit të ekspertizës së ekspertit shqyrtues).

Paneli shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “LOTO 2 – Betonimi i Kanalit të Ujitjes Vrellë-Lubizhdë” me nr. të prokurimit: 633-20-1415-5-2-1, *aktivitet ky i iniciuar nga AK: KK Istog.*

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 /AK/ - “Komuna Istog” (KI) ,

1x1 / OE/ “ Luan SH.P.K & Engineering Group ” SH.P.K – Fushë Kosovë/Deçan

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim Dina

